

TERMAT E REFERENCËS  
MARRËVESHJE KUADËR

ME OBJEKT

"Mbështetje për gjallërimin e aktivitetit social-  
kulturor në funksion të forcimit të identitetit  
rajonal dhe lokal, etj, Faza II"

## Pasqyra Përmbledhëse

1	Hyrje .....	2
2	Synimi i përgjithshëm .....	3
3	Autoriteti kontraktues .....	4
4	Hapësira e ndërhyrjes .....	5
5	Objekti i punës .....	5
6	Përshkrimi i detyrës së Operatorit Ekonomik .....	5
7	Produktet dhe plani i realizimit .....	6
8	Përgjegjësitë e Operatorit Ekonomik .....	6
9	Koordinimi .....	6
10	Konfidencialiteti i dokumentacionit .....	6
11	Kërkesat e raportimit .....	7

### **1 Hyrje**

Ky dokument përmban Termat e Referencës (ToRs) për mbështetje teknike për hartimin e dokumentave të tenderit për "Mbështetje për gjallërimin e aktivitetit social-kulturor në funksion të forcimit të identitetit rajonal dhe lokal, etj, Faza II".

Ndërhyrja: "Mbështetje për gjallërimin e aktivitetit social-kulturor në funksion të forcimit të identitetit rajonal dhe lokal, etj, Faza II", e financuar nga Qeveria Shqiptare përmes programit të financimit IVR, është pjesë e Programit Operacional 2024-2030 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Ky program është një instrument programor zhvillimor me fokus territorial i cili do të garantojë orientimin e investimeve dhe ndërhyrjeve në përputhje me vizionin "Shqipëria 2030".

Programi Operacional i FSHZH-së është një dokument planifikimi, i cili organizon në një plan operacional 7 vjecar objektivat strategjike të institucionit, politikën e Qeverisë së Shqipërisë për Zhvillimin social-ekonomik, drejtimet e zhvillimit rajonal dhe kohezionit siç janë përcaktuar në Ligjin nr. 102/2020, si dhe programet aktive në zbatim dhe ato të dakorduara.

Programi Operacional i FSHZH-së, ka përcaktuar 6 drejtimet kryesore ku do të fokusohen ndërhyrjet transformuese nga FSHZH në përmbushje të objektivave strategjike të zhvillimit rajonal, ku ndërhyrja: "Mbështetje për gjallërimin e aktivitetit social-kulturor në funksion të forcimit të identitetit rajonal dhe lokal, etj, Faza II" bën pjesë në Drejtimin 4 të tij: "Ndërhyrje për rritjen e ndërveprimit dhe sinergjisë mes grupeve të interesit të zhvillimit rajonal dhe vendor."

Arti, kultura & trashëgimia kulturore luajnë një rol kyç në zhvillimin e shoqërisë dhe komunitetit. Pavarësisht mbështetjes

dhe fokusit të shtuar të Qeverisë Shqiptare dhe institucioneve përgjegjëse që operojnë në këtë sektor, konstatohet se jeta kulturore dhe artistike është kryesisht e përqëndruar në kryeqytet dhe disa prej qyteteve më të mëdha të vendit.

Ndërkohë shumë qytete të mesme dhe të vogla, përfshirë dhe zonat rurale kanë mungesë të theksuar të aktiviteteve kulturore - artistike, duke krijuar kështu disbalanca mes komuniteteve. Studimet tregojnë që edhe në zonat me potencial turistik, arti dhe kultura mbeten një potencial i pashfrytëzuar edhe pse komuniteti dhe vizitorët i konsiderojnë ato një element thelbësor në jetën e komunitetit, nxitjen dhe zhvillimin e turizmit.

Gjallërimi i jetës social kulturore në vend konsiderohet si një nga elementet thelbësore për shoqërinë dhe komunitetin. Studimet tregojnë që edhe në zonat me potencial turistik, arti dhe kultura mbeten një potencial i pashfrytëzuar edhe pse komuniteti dhe vizitorët i konsiderojnë ato një element thelbësor në jetën e komunitetit, nxitjen dhe zhvillimin e turizmit.

Kjo paketë parashikon mbështetje të herë pas herë gjatë vitit në trajtë shërbimi ose infrastrukture për gjallërimin e jetës social - kulturore, ndërveprimin dhe forcimin e identitetit të secilës zonë ku do të zhvillohet në të katërt rajonet zhvillimore. Me anë të saj synohet promovimi i rajoneve nëpërmjet eventeve kulturore, sportive, kulinarie, sociale, etj.

Kjo fazë vjen në vijim të një faze të parë të suksesshme, e cila pati impakt të lartë në komunitet si dhe kërkesë të lartë nga bashkitë për vijim.

Rëndësia e këtij projekti qëndron në ndikimin e drejtpërdrejtë social dhe kulturor të pjesëmarrësve, duke përfshirë dhe rritjen e krenarisë në komunitet, shkëmbimin e eksperiencave, rritjen e pjesëmarrjes së banorëve.

## **2 Synimi i përgjithshëm**

Në vijim të një serie ndërhyrjesh si pjesë e strategjisë së zhvillimit rajonal, me anë të këtij investimi, synohet gjallërimi i jetës social - kulturore dhe forcimi i identitetit komunitar, krijimi i frymes pozitive dhe besimit, promovimi i ofertës turistike në bashkitë ku do të aplikohet dhe rritja e ndërveprimit, sinergjise dhe partneritetit mes aktoreve.

Gjithashtu, projekti ka për qëllim promovimin e kulturës dhe artit të shoqërisë shqiptare, promovimin e artistëve të rinj, dhe jo vetëm, nëpërmjet organizimeve të aktiviteteve të ndryshme, si dhe shkëmbimin e përvojave kulturore dhe artistike.

FSHZH nëpërmjet këtij projekti synon të mbështesë 61 bashkitë e Republikës së Shqipërisë në promovimin e vlerave turistike të territorit që mbulojnë duke vënë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme për organizimin e eventeve të tipologjive të ndryshme.

Kjo ndërhyrje përvec rritjes së frymës komunitare dhe realizimit të aktiviteteve, synon më së shumti rritjen e kapaciteteve të bashkive për organizimin e eventeve nëpërmjet vënies në dispozicion të pajisjeve bazë minimale të cilat lejojnë zhvillimin e aktiviteteve sociale dhe rekreative.

Referuar Nenit 25 të Ligjit Nr.139 datë 17.12.2015“Për Vetëqëverisjen Vendore”, lidhur me funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese, bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve;
- Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve;
- Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Zhvillimi i aktiviteteve, përvec të tjerave kërkon një infrastrukturë e cila përfshin pajisje si: struktura informuese, struktura të cilat presin aktivitet tregtare të përkohëshme, podium/stage, sistem audio, sistem ndricimi, etj. Aktualisht, jo të gjitha bashkitë (dhe sidomos bashkitë e vogla) kanë kapacitetet teknike dhe infrastrukturën e nevojshme për vetëorganizimin e eventeve. Zakonisht, në të tilla raste ato kërkojnë mbështetje nga ekspertë të jashtëm/operatorë ekonomikë. Operatori Ekonomik duhet të konsiderojë se eventet që do të realizohen janë të ndryshme në tipologji dhe madhësi dhe si rrjedhojë edhe pajisjet janë të ndryshme në varësi të eventit.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është të adresojë mungesën e aktiviteteve kulturore dhe artistike në qytetet vogla, si dhe në zonat rurale të Shqipërisë. Përmirësimi i jetës kulturore dhe sociale në këto zona, do të stimulojë gjithashtu edhe zhvillimin e turizmit dhe të forcojë identitetin kulturor të secilës zonë.

### **3 Autoriteti kontraktues**

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) është autoriteti kontraktues për këtë kontratë. FSHZH është një agjenci, misioni i së cilës

është promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, nivel të balancuar dhe kohezion rajonal dhe lokal. Kuadri ligjor për krijimin dhe funksionimin e FSHZH-së përbëhet nga Ligji nr.10130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit". FSHZH zbaton projekte të financuara nga Donatorët Ndërkombëtarë dhe Qeveria shqiptare me fushën e zhvillimit lokal dhe rajonal.

#### **4 Hapësira e ndërhyrjes**

Projekti shtrihet në territorin e 61 bashkive të Republikës së Shqipërisë.

#### **5 Objekti i punës**

FSHZH nëpërmjet kësaj Marrëveshje Kuadër synon të mbështesë 61 bashkitë e Republikës së Shqipërisë në promovimin e vlerave turistike të territorit që mbulojnë duke vënë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme për organizimin e eventeve të tipologjive të ndryshme.

Objekti i punës është: "Mbështetje për gjallërimin e aktivitetit social-kulturor në funksion të forcimit të identitetit rajonal dhe lokal, etj, Faza II". Ndërhyrja do të synojë gjallërimin e jetës social - kulturore dhe forcimin e identitetit të rajoneve të vendit dhe diversifikimin e ofertës turistike në bashkitë ku do të aplikohet.

Gjithashtu do të synohet:

- Promovimi i artit dhe kulturës;
- Promovimi i artistëve të rinj, dhe jo vetëm, nëpërmjet organizimeve të aktiviteteve të ndryshme;
- Shkëmbimi i përvojave kulturore dhe artistike

#### **6 Përshkrimi i detyrës së Operatorit Ekonomik**

Operatorët ekonomikë do të fokusohen në kryerjen e detyrave të mëposhtme:

***Detyra 1. Vënien në dispozicion të pajisjeve për realizimin e eventeve, sipas kërkesës nga Autoriteti Kontraktor;***

Për realizimin e kësaj detyre, Autoriteti Kontraktor do të vërë në dispozicion OE një listë të miratuar për eventet që do të realizohen duke përfshirë informacionin specifik lidhur me kohën, vendodhjen, kohëzgjatjen dhe mbështetjen e nevojshme.

Kjo listë do të detajohet në një proces paralel ku bashkitë do të aplikojnë nëpërmjet një thirrje për nevojat e kryerjes së eventeve.

Operatori Ekonomik duhet të jetë në gjendje të vërë në dispozicion pajisjet sipas listës së përmendur më lart në kohë dhe cilësi, specifikimet teknike të të cilave gjenden në Aneksin 1 të këtyre ToR.

### ***Detyra 2. Sigurimin e transportit të pajisjeve në vendodhjen e eventit***

Operatorët ekonomikë kanë për detyrë mbulimin e shërbimit të transportit të pajisjeve në vendodhjen e eventit dhe kostove përkatëse.

### ***Detyra 3. Operimin e pajisjeve duke përfshirë edhe suportin teknik gjatë gjithë procesit të organizimit të eventit***

Stafi i operatorit ekonomik duhet të jetë prezent gjatë eventit për të siguruar operimin e pajisjeve dhe për të marrë masa në rast problemi teknik të shfaqur gjatë eventit.

Në përfundim të cdo eventit, OE duhet të dorëzojë një raport\memo informuese ku të përshkruhet gjithë procesi i sigurimit të pajisjeve shoqëruar me faturën.

## **7 Produktet dhe plani i realizimit**

OE do të realizojë detyrat në një periudhë kohore 3 vjecare ose deri në përfundimin e fondit të parashikuar për këtë projekt.

OE do të raportojë tek FSHZH për problemet teknike, aprovimin e raporteve dhe çështjet administrative. Të gjitha raportet dhe materialet do të dorëzohen tek FSHZH për rishikim dhe aprovim. Duhet të ketë diskutime të rregullta interaktive dhe raportime midis OE dhe Klientit për të bërë të mundur zbatimin e kontratës në mënyrë eficiente.

## **8 Përgjegjësitë e Operatorit Ekonomik**

OE është përgjegjës për realizimin në tërësi të detyrave të përcaktuara në objektivat e detyrës së ngarkuar. Në këtë aspekt, OE do të mbulojë të gjitha kostot që kanë të bëjnë me punësimin dhe angazhimin e ekipit të tij. Kjo përfshin edhe shpenzimet e udhëtimit, ushqimit dhe akomodimit.

## **9 Koordinimi**

OE do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me FSHZH dhe Njësitë e Vetqeverisjes Vendore për realizimin e detyrës.

## **10 Konfidencialiteti i dokumentacionit**

OE do të trajtojë në mënyrë konfidenciale informacionin e marrë dhe të përfituar gjatë detyrës dhe do ta përdorë atë vetëm në shërbim të kryerjes së kësaj detyre.

## **11 Kërkesat e raportimit**

OE do raportojë pranë FSHZH, sipas menyres dhe afateve të saktësuar;

Raportimi duhet të jetë në shqip (me shkrim dhe imazhe);

FSHZH do të monitorojë aktivitetet e OE me mbështetjen e bashkive ku kryhen aktivitetet;

OE duhet të ofrojë informacion sa herë që ti kërkohet;

FSHZH do të rishikojë dhe aprovojë të gjitha dokumentet e dorëzuara nga OE

Aneks 1. Lista dhe specifikimet teknike të zërave të kërkuara